



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

---

# PAKETA FISKALE

2004



*TIRANË, DHJETOR 2003*

## Permbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Analiza e situates fiskale.....	6
3. Objektivat afatmesem te reformes ne administraten fiskale.....	14
3.1. Reforma ne Administraten Doganore.....	14
3.2. Reforma ne Administraten Tatimore.....	16
4. Permbajtja e kerkesave te prezantuara per paketen fiskale dhe argumentimi i nivelit te pranimit te tyre.....	19
4.1. Zbatimi i angazhimeve ndaj OBT, per vitin 2004 dhe vitet e meparshme.....	19
4.2. Permbajtja e kerkesave te shprehura nga biznesi dhe ministrite sektoriale.....	23
5. Permbajtja projektakteve ligjore te paketes fiskale te vitit 2004.....	34
6. Efektet e Paketes Fiskale 2004 ne Buxhet .....	44
6.1. Efektet e Paketes Ligjore te Tatimeve.....	44
6.2. Efektet e ndryshimeve ne tarifate Doganore.....	44

## **1. Hyrje**

Pjese e pandare e pergjegjesise ne rritje te maxhorances socialiste, padyshim qe eshte edhe serioziteti ne bashkerendimin e politikës fiskale me procesin e hartimit te projekt buxhetit te shtetit. Tashme është kthyer në traditë që Ministria e Financave i paraqet të bashkërenduara në kohë Paketën Fiskale me Projekt-Buxhetin e vitit pasardhës.

Paketa me draftet e akteve ligjore qe ju paraqesim sot per diskutim dhe miratim eshte rrjedhoje e një pune disamujore të ekspertëve përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe strukturave të saj, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrise se Drejtësisë, biznesit etj. Duke marrë në konsideratë faktin që akte të tilla të rëndësishme si ligji për akcizat, ligji për procedurat tatimore etj, u ripunuan në mënyrë thelbësore gjatë vitit të kaluar, si dhe kohën relativisht të shkurtër të zbatimit të tyre, (gjashtë muaj) gjatë procesit të diskutimit u synua që shkalla e ndryshimeve të buronte nga:

- Nevoja e implementimit në një masë të nevojshme, në përputhje edhe me Planin e Veprimit të rekomandimeve të studimit për reduktimin e barrierave administrative
- Implementimi i rekomandimeve të BE-së në funksion të procesit të negocimit të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në mënyrë të veçantë të konsolidimit fiskal te taksës se rrugës Durrës-Kukës-Morinë
- Të zbatimit të angazhimeve nga marrëveshjet me Institucionet Financiare Ndërkombëtare, OBT-së, FMN-së etj...

Gjatë procesit të diskutimit për nivelin e përfshirjes në paketën fiskale të propozimeve të ardhura, krahas nevojës së ruajtjes së ritmeve të larta të rritjes së të ardhurave, vëmendja është përqendruar dhe në reflektimin e zhvillimeve aktuale të ekonomisë vendase, nivelin e investimeve private vendase dhe të huaja, gjithnjë në rritje gjatë këtyre viteve të fundit, ne politikat fiskale dhe nivelet e taksave doganore në veçanti.

Bashkërendimi i këtij procesi me nevojën e rivlerësimit brenda hapësirave negociuese të angazhimeve në kuadrin e OBT-së, së bashku me ekspertët e Ministrisë së Ekonomisë dhe ekspertët e grupit negociator të BE-së mendojmë se do të sigurojë kushtet e nevojshme për konsolidimin në tregun shqiptar të prodhimit vendas dhe nga ana tjetër një harmonizim më të drejtë të këtij procesi me integrimin rajonal e më gjerë.

Duhet të nënvizojmë se përmes kësaj pakete kryhen ndryshime të legjislacionit fiskal, me synim përmirësimin progresiv dhe përafrimin me standardet europiane duke i kushtuar rëndësi reduktimit të qëndrimit subjektiv të administratës fiskale ndaj biznesit, por edhe ndryshime që realizojnë në veçanti një ulje të nivelit të taksave doganore dhe një zvogëlim progresiv të barres fiskale përmes zgjerimit të bazës së tatueshme e reduktimit progresiv të informalitetit dhe evazionit fiskal.

Elementet e kësaj pakete fiskale në teresinë e tyre, janë konsultuar me ekspertet e huaja që asistojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Ministrisë së Financave. Ato janë negociuar dhe bërë pjesë e programeve të financuara nga Bashkimi Europian, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

***Paketa Fiskale 2004 synon:***

- Të garantojë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, konsolidimin e të ardhurave fiskale në funksion të realizimit të shpenzimeve në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm dhe uljes së deficitit të përgjithshëm buxhetor, në mbështetje të objektivave të parashikuara në Programin afatmesëm të Qeverisë për vitet 2004-2006 dhe marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare.
- Të kontribuojë në reduktimin e mëtejshëm të evazionit fiskal e kontrabandën dhe të garantojë fuqizimin e administratave tatimore dhe doganore në funksion të forcimit të funksioneve investiguese e kontrolluese.
- Të përafrojë legjislacionin dhe praktikën fiskale me ato të BE-së. me objektiv integrimin europian;
- Të krijojë një klimë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm të biznesit vendas dhe të huaj dhe kushte lehtësuese për zhvillimin e industrisë në vend nëpërmjet uljes së tarifave doganore për një sërë produktesh;

- Të realizojë një mjedis me te favorshem ligjor për biznesin vendas dhe atraktiv për biznesin e huaj përmes thjeshtimit dhe lehtësimit të procedurave tatimore, rritjen e metejshme të transparences në marrjen e vendimeve dhe procedurave ankimuese, publikimin në gazetën zyrtare dhe pamflete të ligjeve të reja fiskale etj;
- Vazhdimin e konsolidimit të legjislacionit fiskal dhe veçanërisht ligjit të akcizave, procedurave tatimore, tatimit mbi të ardhurat etj.
- Implementimi i reformës për transferimin e të drejtës për të mbledhur kontributet shoqërore dhe shëndetësore.

## **2. Analiza e situates fiskale**

Zhvillimet ekonomike gjate vitit 2003 pergjithesisht kane qene ne perputhje me parashikimet. Ne baze te analizes se ecurise se treguesve kryesore ekonomike parashikohet qe deri ne fund te vitit 2003 te arrihet objektivi kryesor per nje rritje ekonomike prej rreth 6 perqind, inflacion ne kufijte 2-4 perqind dhe deficit ne kufijte 4.6%.

Treguesit e rritjes ekonomike ne te gjitha sektoret e ekonomise jane te dukshem, por me e theksuar kjo rritje eshte ne sektorin e ndertimit dhe te sherbimeve perkatesisht me 11.5 perqind dhe 6.7 perqind. Rritja ne sektoret kryesore te ekonomise eshte shoqeruar edhe me nje permiresim te struktures se ekonomise, duke cuar ne nje ulje te peshes specifike ne sektorin e bujqesise, dhe ne nje rritje te kesaj peshe per sektoret e tjere si sherbime, ndertim, transport.

Te ardhurat nga administratat tatimore dhe doganore per vitin 2003 vleresohet te arrijne ne rreth 114 miliarde Leke ku peshen kryesor e mban Tatimi mbi Vleren e Shtuar me rreth 51 miliarde Leke duke mbajtur perafersisht 45 perqind te peshes se te ardhurave nga tatimet dhe doganat, te ardhurat nga akciza me rreth 12.8 miliard leke duke mbajtur rreth 11.3 perqind te peshes se te ardhurave.



Bazuar ne realizimin e pritshem te vitit 2003, programin e rritjes ekonomike, nivelin e pritshem te inflacionit, efektet e paketes se re fiskale dhe reformes fiskale ne pergjithesi, per vitin 2004 parashikohet qe te ardhurat nga administrata tatimore dhe doganore te arrijne ne rreth 129.6 miliarde leke ose nje rritje me rreth 14 perqind kundrejt vitit 2003, per te arritur nivelin prej 15.8% te PBB-se, nderkohe qe ne fund te vitit 2003 keto te ardhura priten te zene rreth 15.3% te PBB-se.

Nga analiza e viteve te fundit ne te ardhurat tatimore per disa nga taksat indirekte dhe direkte qe aplikohen si ne vendin tone si edhe ne vendet e Rajonit dhe Komunitetit European rezulton se, te ardhurat tatimore nga TVSH ne raport me PBB-se, luhaten ne nivelet 6-8 perqind, shifer qe perafrohet me performacen tone ne periudhen 1998-2002.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vleresim	Program
<b>Kroaci</b>	14.7	13.9	13.6	13.5			
<b>Siloveni</b>		5.7	9.9	9.6	8.4		
<b>Greqi</b>	7.6	7.8	8.3	8.4			
<b>Bullgari</b>	8.2	8.1	8.8	8.3			
<b>Maqedoni</b>	4.5	4.8	7.4	7.3	8.5		
<b>Poloni</b>	7.7	7.9	7.6	7.3			
<b>Shqipëria</b>	6.2	5.9	7.2	6.7*	6.7	6.8	7.0
<b>Rumani</b>	6	6	6.3	6.4			

\* **Shenim:** Ne vitin 2001 miratohet VKM 49 e cila perjashton nga pagimi i TVSH-se mallrat makineri dhe pajisje per investimet private, dhe ne te njejten kohe ulet edhe tarifa doganore per to ne vetem 2% impakti i te cilave perlogaritet vetem ne vitin 2001 ne afro 2 miliarde leke. Ne vitet 2002-2003 ky efekt eshte edhe me i ndjeshem pasi zhdoganimi i makinerive dhe paisjeve ka sjelle abuzim ne klasifikimin e kesaj kategorie.

**Tabela 1. TVSH ne perqindje me PBB-ne**





**Grafiku 1. TVSH ne perqindje me PBB-ne**

Ne lidhje me te ardhurat personale, megjithese ndihet nje tendence e lehte ne rritje ne mbledhjen e ketyre te ardhurave, vihet re nje diference e konsiderueshme e performances tone krahasuar me vendet e rajonit, gjate gjithë periudhes gje e cila reflektohet edhe ne nje nivel te ulet te ne mbledhjen e ketyre te ardhurave (ne vetem 1% te PBB-se). Nderkohe qe mesatarja e kesaj takse luhetet nga 4 - 6.5% te PBB-se ne vendet e rajonit.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vleresim	Program
Siloveni	6.6	6.3	6.4	6.3	6.3	6.3	6.3
Greqi	4.4	4.8	4.4	4.3		4.3	
Kroaci	5.9	5.3	4.8	3.8		3.8	
Bullgari	4.6	4.4	4.1	3.6		3.6	
Rumani	5	5.2	3.4	3.2		3.2	
Poloni	6.3	3.8	3.4	3.2		3.2	
Maqedoni	4.7	4.9	4.6	3.1	3.1	3.1	3.1
<b>Shqiperia</b>	<b>0.3</b>	<b>0.6</b>	<b>0.8</b>	<b>1.0</b>	<b>0.91*</b>	<b>0.89*</b>	<b>0.99</b>

\* Shenim: ulja e peshes se kesaj te ardhure ne perqindje te PBB-se, vjen si rezultat i uljes se normave te interesave bankare, terheqjes se depozitave ne vitin 2002, si dhe ndryshimit te nivelit te te ardhurave se tatueshme nga 10 – 14 000 leke.

**Tabela 2. Tatimi i te ardhurave personale ne perqindje me PBB-se**





**Grafiku 2. Tatimi i te ardhurave personale ne perqindje me PBB-se**

Nivelin i realizimit te te ardhurave nga akciza gjate periudhes 1998-2002, pavaresisht nje performance afersisht konstante, mbetet me i ulet vihet re nje performance konstante por me e ulet ne krahasim me vendet e rajonit e te Komunitetit Europian, vetem me rreth 1.8% te PBB-se nga 2.6 - 5% te PBB-se ne vendet e rajonit. Aresye kryesore eshte niveli rreth 2-3 here me i ulet i tarifave per kete takse ne krahasim me ventet e rajonit e te Komunitetit Europian.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vlresim	Program
Kroaci	4.3	4.3	4.6	4.9			
Maqedoni	5.2	5.1	5.2	4.6	4.5		
Poloni	3.8	4.1	4	4			
Bullgari	3	2.9	3.9	3.7			
Siloveni		1.9	3.3	3.6	3.4		
Greqi	3.9	3.7	3.5	3.5			
Rumani	2.3	3.1	2.6	2.4			
<b>Shqiperia</b>	<b>1.07</b>	<b>1.38</b>	<b>1.7</b>	<b>1.6</b>	<b>1.4</b>	<b>1.72</b>	<b>1.79</b>

**Tabela 3. Akciza ne perqindje te PBB-se**





**Grafiku 3. Akciza ne perqindje te PBB-se**

Ne lidhje me tatimin mbi fitim mund te themi se performanca jone gjate periudhes 1998-2002 eshte e ngjashme me ate te vendeve te rajonit megjithese mbetet ende per te bere per te arritur nivelet e Bullgarise e Greqine.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vleresim	Program
Bullgari	3.8	3.1	2.8	3.9			
Greqi	2.8	3	3.8	3.9			
Rumani	3	3.1	2.5	1.9			
Poloni	2.7	2.4	2.5	1.8			
<b>Shqipëria</b>	<b>0.94</b>	<b>1.19</b>	<b>1.5</b>	<b>1.7</b>	<b>1.8</b>	<b>1.77*</b>	<b>1.85</b>
Kroaci	2.5	2.3	1.5	1.7			
Siloveni	1.2	1.2	1.3	1.5	1.5		
Maqedoni	0.9	1.2	1.2	1.3	1.1		

\* Shenim: Performanca e ulet e situates financiare te kompanive shteterore si Albtelemek, KESH, dhe Insig

**Tabela 4. Tatimi mbi fitimin ne perqindje me PBB-se**





**Grafiku 4. Tatimi mbi fitimin ne perqindje me PBB-se**

Ne lidhe me taksat doganore veme re nje tendence te pergjithshme ne ulje dhe kjo si pasoje e konsolidimit te ekonomise, procesit te integritimit respektimit te orientimeve te OBT qe kane ndermarre te gjitha vendet e rajonit. Pesha e te ardhurave nga kjo takse ne perqindje te PBB-se eshte e krahasueshme me nivelin e kesaj te ardhure ne vendet e rajonit.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vleresim	Program
Poloni	6.1	5.6	5.1	4.1	3.6		
Maqedoni	3.5	4	3.3	2.6	2.6		
<b>Shqipëria</b>	<b>2.74</b>	<b>2.26</b>	<b>2.5</b>	<b>2.1</b>	<b>2.0</b>	<b>1.93</b>	<b>1.79</b>
Kroaci	3	3	2.4	2.3	2.0		
Rumani	1.5	1.4	1.1	0.8	1.0		
Bullgari	2	1.1	0.8	0.7	0.7		
Siloveni	1.5	1.3	0.9	0.6	0.6		

**Tabela 5. Taksat doganore ne perqindje me PBB-se**



**Grafiku 5. Taksat doganore ne perqindje me PBB-se**

Niveli total i te ardhurave fiskale ka nje tendence ne rritje per periudhen ne shqyrtim, por ndonse ai eshte ne nje nivel te perafert me ate te Maqedonise, Polonise vleresohet me e ulet se i vendeve te rajonit dhe Komunitetit Europian.

Duhet shenuar se ne periudhen 2002 – 2004 krahas me nje rritje ekonomike 6 perqind, evihentohet nje rritje e te ardhurave nga doganat dhe tatimet me rreth 1 perqind PBB kryesisht si rezultat i rritjes se tarifave e performances se akcizes, konsolidimit te TVSH-se etj.

Keshtu nga analiza e mesiperme rezulton se vemendja duhet orientuar ne drejtim te performances se aktivitetit te administrates fiskale, reduktimit te evazionit fiskal dhe zgjerimit te bazes se taksueshme.



## “PAKETA FISKALE 2004”

Iniciativat e reja fiskale per vitin 2004, nder te tjera kane parasysh edhe permiresimin e punes lidhur me keto dy taksa. Keshtu tatimi mbi te ardhurat personale pritet te permiresohet ndjeshem (rreth 24% me shume sesa realizimi i pritshem i vitit 2003) si rezultat i reformes ne transferimin e kompetences per mbledhjen e kontributeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore e fillimisht per 300 bizneseve te medha, per te vazhduar ne fillim te vitit 2004 me institucionet buxhetore. Kjo mase do te sjelle per rrjedhoje edhe nje kontroll dhe mbledhje me te mire te tatimit mbi te ardhurat personale.

Po keshtu duke dashur te kompensojme efektin e heqjes se takses se rruges Durres - Kukes nisur edhe nga analiza krahasuese e nivelit te taksave me vendet e rajonit, perlogariten efekte pozitive si rezultat i rritjes se akcizes se karburanteve.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
						Vlresim	Program
Kroaci	46.9	43.7	40.8	39.7			
Sloveni	40.0	41.1	39.6	39.4	37.6		
Rumani	29.7	31.8	31.2	30.4			
Bullgari	29.8	29.4	29.9	28.8			
Greqi	24.6	25.9	26.6	26.6			
Maqedoni	18.9	20.0	21.6	20.3	22.6		
Shqiperia	12.3	12.9	18.9	18.7	19.0	20.1	20.7
Poloni	21.7	19.2	18.2	17.1			

**Tabela 6. Te ardhurat fiskale ne perqindje te PBB-se**



**Grafiku 6. Te ardhurat fiskale ne perqindje te PBB-se**

## ***“PAKETA FISKALE 2004”***

---

Ne perfundim te kesaj analize, krahasimi me te dhenat e vendeve e rajonit e me gjere mund te themi se performanca e administratave fiskale shqiptare eshte e kenaqshme ne taksa te tilla si TVSH- ja dhe taksa doganore, por fokusi kryesor ne rritjen e performances per vitin 2004 dhe vitet ne vazhdim do te jene taksa te tilla si “Tatimi mbi te ardhurat personale”, nderkohe qe tarifat per akcizat jane 2-3 here me te uleta. Permiresimi i treguesve ne keto zera do te rrise edhe nivelin e pergjithshem te te ardhurave fiskale ne raport me PBB-ne.

### **3. Objektivat afatmesem te reformes ne aministraten fiskale**

#### **3.1 Reforma ne Administraten Doganore**

Shqiperia tashme ka hyre me nje ritem konsistent ne proceset e integrimit te saj ne Bashkimin European dhe ne realitetin ekonomik rajonal dhe global. Zbatimi i marreveshjes me OBT dhe aplikimi i MTL-ve me nje numer ne rritje vendesh, negocimi ne proces i kapitujve te rendesishem te Marreveshjes se Stabilizimi Asocimit te lidhura me reduktimin e tarifave te importeve dhe eksporteve me BE-ne pashmangshmerisht do ta ekspozojne ekonomine shqiptare kundrejt konkurrences me tregjet me te zhvilluara europiane dhe rajonale, duke u bere nxites i fuqishem i profilizimit te ekonomise dhe zhvillimeve te ardhshme sektoriale.

Nga ana tjeter ritmet e qendrueshme te rritjes ekonomike po e zvogelojne gjithnje e me teper mundesine qe Shqiperia te vazhdoje te perfitoje kredi koncesionale apo grante per te financuar zhvillimin e saj ne perputhje me prioritetet e vendosura ne Strategjine Kombetare per Zhvillim Ekonomik dhe Social. Burimet e ardhshme te financimit te ketyre prioriteteve te zhvillimit do te jene kredite me terma tregtare dhe gjenerimi i te ardhurave brenda vendit.

Ne keto kushte, sfida kryesore me te cilen perballlet administrata fiskale eshte pikerisht sigurimi i financimit te reformave e progresit ne sektoret prioritare te arsimit, shendetesise, infrastruktures rrugore, energjitike etj. Perafrimi i legjislacionit dhe performances fiskale me ate te Europes se zhvilluar eshte ne themel te reformes se ndermarre si ne administraten doganore ashtu edhe ate tatimore.

Kompjuterizimi i sherbimeve fiskale; aplikimi i standarteve rigoroze te rekrutimit, testimit dhe vleresimit te punes se doganierëve dhe tatimoreve; rritja e transparences dhe pergjegjshmerise se tyre kundrejt kontribuesve fiskale; eliminimi i dublimeve dhe kundershtimeve ne legjislacionin fiskal dhe harmonizimi i tij me ate european; permiresimi i sherbimeve fiskale kundrejt sipermarresve; zbatimi me rigorozetet i ligjeve fiskale si nga

nepunesit e administrates fiskale ashtu edhe nga sipermarresit; zbatimi rigoroz i penaliteteve ligjore si per nepunesit e administrates fiskale ashtu dhe per sipermarresit qe u shmangen detyrimeve ne forma te ndryshme.

***Reforma e administrates doganore gjate vitit 2004 do te konsistoje ne:***

- Vazhdimin e implementimit te programit te automatizimit te sistemit te perpunimit te te dhenave doganore (ASYCUDA ++), ne perputhje me planin e miratuar te veprimeve (hapjen ne deget doganore si Elbasan, Kakavije, Kapshtice, Qafe-Thane, etj.), si dhe masat per sigurimin e qendrushmerise se sistemit, me pasoje rritjen e cilesise se informacionit per manaxhim dhe analize (ju informojme se eshte implementuar tashme ky sistem ne doganen e Tiranës dhe ne janar te vitit 2004 do te implementohet edhe ne Durres).
- Forcimin e funksionit te Kontrollit te Brendshem, si ne aspektin e rritjes se efektivitetit te kontrollit financiar ashtu dhe rritjen e efciences se elementeve te auditimit qe siguron mireadministrimin e pergjithshem.
- Ne kuader te lehtesimit te tregtise, permiresimin e indikatoreve te performances doganore (ulja e kohes se zhdoganimit, rritjen e numrit te deklarave te perpunuara per njesi personeli doganor, etj.)
- Forcimin e metejshe i zbatueshmerise korrekte te klasifikimit tarifor te mallrave, me qellim maksimizimin e te ardhurave doganore dhe rritjen e saktesis se statistikave tregtare.
- Permiresimin e menaxhimit dhe rritjen e efikasitetit te Departamentit Operativ dhe Hetimor, nepermjet rritjes se efektivitetit te sherbimit te inteligjences doganore, me output analizat cilesore te riskut;
- Forcimin e bashkepunimit bilateral dhe multilateral ne fushen e shkembimit te informacionit ne vendet e rajonit dhe ato me te cilat vendi yne ka shkembimin tregtar me te madh.
- Forcimin e bashkepunimit me institucionet brenda vendit, me qellim ekzekutimin e ligjit dhe luften kunder korrupsionit, perfshire ketu edhe zhvillimin e kuadrit ligjor per bashkepunim bilateral dhe multilateral me perparesi, zhvillimin e strukturave per bashkepunim doganor dhe integrim me BE.

- Zgjerimin dhe konsolidimi e kontrollit pas zhdoganimit per ta shnderruar kete sherbim ne nje instrument te sigurimit te kontrollit ne fushen e zbatimit korret te legjislacionit doganor ne teresine e tij
- Rritjen e efikasitetit tek zyrtaret drejtues nepermjet percaktimit te qarte te pergjegjesive, roleve dhe kompetencave, te qarta lidhur me decentralizimin e vendim-marrjes dhe delegimit te kompetencave, konform strukturave menaxheriale.
- Forcimin dhe krijimin e lehtesirave per bashkepunim midis institucioneve qeveritare te ngarkuara me pune ne pikat kufitare doganore brenda vendit nen ombrellen e Menaxhimit te Integruar te Kufijve dhe strategjive qeveritare perkatese.
- Rritjen e transparences dhe informimit per publikun dhe komunitetin tregtar.
- Modernizimin e strukturave me qellim marrjen e pergjegjesive me te zgjeruara ne fushen e luftes se trafikut te droges dhe perkursoreve, luften kunder trafikut te armeve, municionit, perfshire mallrat me perdorim dyfishte si dhe trafikut te makinave te vjedhura.
- Hartimin e nje strukture te qendrueshme per kualifikimin profesional te personelit doganor ne te gjithe vendin, per te siguruar se personeli ka marre trainimin ne kohen dhe vendin e duhur.

### **3.2. Reforma ne Administraten Tatimore**

Ne administraten tatimore do te vazhdoje procesi i reformimit edhe gjate vitit 2004 e ne vazhdim ne drejtim te strukturimit, te rishikimit te legjislacionit, te permiresimit te procedurave dhe metoditkave te dokumentimit te tyre, te informatizimit te sistemit tatimor si dhe ofrimit te praktikave me te mira te punes, duke e afruar gjithnje e me shume sistemin tone tatimor me ate te vendeve te Bashkimit European ne menyre qe te perballoje sfidat e ardheshme te integrimit.

#### ***Nder aktivitetet prioritare ne planin e veprimit perfshihen.***

##### ***Permiresimet strukture***

- Zbatimi praktik funksional i struktures organizative te implementuara ne deget tatimore dhe ne Zyrat Qendrore te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve duke perfshire manualet proçeduriale, ushtrimin e te gjitha funksioneve qe kjo strukture ofron si dhe implementimit te programeve.

- Implementimi i sistemit te informatizuar tatimor dhe te integruar, shtrirjen e tij gjeografike dhe per te gjitha llojet e tatimeve (vazhdimsi e informatizimit te TVSH dhe Tatimi fitimit).
- Implementimi i akcizes ku theksi do te vihet ne forcimin e procedurave te kontrollit, marreveshjet dhe garancite bankare si dhe ngritja e kapaciteteve te burimeve njerezore permes trainimeve.
- Implementimi i procedurave per mbledhjen e kontributit te Sigurimeve Shoqerore sipas afateve kohore te percaktuara me strukturat e tjera ne bashkepunim me asistencen e huaj.
- Forcimi dhe dokumentimi i sistemeve dhe procedurave te brendshem nepermjet plotesimit te dokumentacionit ne lidhje me to, si dhe riorganizimi e plotesimi si nga ana strukturore ashtu dhe nga ajo cilesore e sektorit te burimeve njerezore.
- Hartimi i nje sistemi te ri apelimesh.

### ***Rishikimi i legjislacionit***

Me perfundimin e konsolidimit te legjislacionit dhe te udhezimeve te identifikimit te anomalive si dhe me synimin e draftimit te ligjeve tatimore ne nje linje me ato te BE administrata tatimore do te hartojte kuadrin ligjor qe perfshin:

- Permiresimin e ligjit te procedurave tatimore (perfshire sistemin e apelimeve)
- Rishikimin me qellim permiresimin e ligjit per tatimin mbi fitimin dhe tatimin mbi te ardhurat personale
- Rishikimin dhe permiresimin e ligjit per taksat nacionale
- Rishikimin dhe permiresimin e ligjit per tatimin mbi lojrat e fatit
- Rishikimin dhe permiresimin e ligjit per tatimin mbi biznesin e vogel
- Rishikimin dhe permiresimin e ligjit te TVSH-se
- Rishikimin i ligjit per akcizen
- Rishikimin i ligjit per sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

### ***Forcimi i aftesive audituese ku theksi do te vihet:***

- Ne programin dhe hartimin e metodikave per vleresimin e riskut dhe zgjedhjes se subjekteve per kontroll.

- Ne formulimin dhe implementimin e nje programi te plote trajnimi per inspektoret e kontrollit tatimor
- Ne rritjen e kapaciteteve operacionale per sektorin e kontrollit ne DPT dhe ne deget tatimore
- Ne formulimin e praktikave standarte per kontrollin e bankave, shoqerive te sigurimit, telekomin e firmat e tjera
- Ne formulimin dhe implementimin e database te sektorit informative
- Ne pergatitjen e udhezuesve dhe metodikave per ngritjen dhe funksionimin me efektivitet te sistemit per monitorimin e investigimit

#### **4. Permbajtja e kërkesave të prezantuara për paketën fiskale dhe argumentimi i nivelit të pranimit të tyre**

##### **4.1. Zbatimi i angazhimeve ndaj OBT-se, për periudhën 2000-2003 dhe vitin 2004.**

Procesi i vleresimit të nivelit të tarifave doganore, ishte pjesë e rëndësishme e paketës fiskale 2004 dhe rezultati i një pune disa mujore të eksperteve të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, ministrive të linjës, përfaqësuesve të biznesit etj.

Projekt ligji që po ju paraqesim për miratim reflekton në mënyrë të plotë komentet dhe sugjerimet e bera gjatë diskutimit të tij në Komitetin Nderministror të Politikave Ekonomike dhe mbledhjen e Keshillit të Ministrave.

Pa dyshim që puna filloi me evidencimin e detyrimeve që buronin nga respektimi i angazhimeve në kuadrin e OBT-se për vitin 2004. Gjatë këtij procesi, njëkohësisht duke vlerësuar nevojën e respektimit edhe të angazhimeve të prapambetura, të paplotesuara nga vitet e kaluara, u punua për saktësimin e plotë të tyre.

Prezantimi në Keshillin e Ministrave i Ligjit “Për nivelet e tarifave doganore” u bë me dy variante. Varianti I parë i cili morri në konsideratë zbatimin e plotë të angazhimeve të prapambetura për periudhën 2000 – 2003 dhe të angazhimeve të reja për vitin 2004. Varianti i dytë morri në konsideratë respektimin e plotë të angazhimeve të prapambetura për periudhën 2000 – 2003, dhe implementimin e pjesshëm të angazhimeve të vitit 2004. Për secilin nga variantet u prezantua impakti fiskal dhe mundësitë e perballimit të tyre. Mbas diskutimeve dhe vlerësimeve të gjithanshme, Keshilli i Ministrave sugjeroi dhe miratoi variantin e implementimit të pjesshëm të angazhimeve të OBT-se për vitin 2004, duke ngarkuar njëkohësisht ministrin përkatës për fillimin e procedurave për notifikim në sekretariatit të OBT-se.

Në marrjen në mënyrë të pjesshme në konsideratë të angazhimeve të skedulit për vitin 2004, u vlerësua nga njëra anë nevoja e ruajtjes së ritmeve të rritjes të të ardhurave fiskale si faktor për të përballuar shpenzimet në sektoret prioritarë si arsim, shëndetësi etj;

por edhe rivleresimi i zhvillimeve ekonomike ne Shqiperi pas procesit te antaresimit ne OBT-e.

Ne menyre te permbledhur po paraqesim

- Per vitin 2004, sipas OBT-se, jane rreth 1000 kode tarifore, tarifa e te cileve reduktohet ne nivele te ndryshme.

Nderkohe per disa grup mallrash :

- Kimikate organike te kapitullit 29
- Pleheruesit e kapitullit 31
- Disa agjente organike me veprim te siperfaqshem, kapitulli 34
- Disa lloje ngjitesish, kapitulli 35
- Bombula gazi te lengshem, kapitulli 36
- Mallra fotografike dhe kinematografike, kapitulli 37
- Produkte te ndryshme kimike, kapitulli 38
- Forma primare plastike, kapitulli 39

niveli aktual i tarifes doganore eshte me i ulet sesa angazhimi sipas OBT-se per vitin fiskal 2004.

- Te ndara sipas grupeve, mallrat qe perfitojne reduktim sipas skedulit te OBT-se per vitin 2004 jane:
  - birre
  - ekstrakte me origjine vegjetale, estere etj.
  - lende ngjyrosese, pigmente, llaqet ngjyrosese
  - smalte, glazura e bojra glazure te perdorura ne industrine e qeramikes e te qelqit
  - vajra esenciale
  - perzierjet e substancave aromatike te perdorura ne industrine e pijeve
  - substanca albuminoidale, ngjitesa te ndryshem
  - mbetje , kthime dhe monofilamente prej plastike
  - Preforma plastike
  - trungje halore e jo halore, qymyr druri, artikuj druri, etj.
  - leter, disa lloje kartonesh, ambalazhesh prej letre e kartoni

- Te ndara sipas grupeve, mallrat qe perfitojne reduktim te pjesshem (jo ne nivelin tarifor sipas skedulit te OBT-se) per te cilat shtrirja e reduktimit zgjatet ne vite jane:
  - vajra thelbesore
  - preparate pastruese
  - artikuj plastike si: tuba, pipa prej polimereve
  - fleta rimesoje, panele e artikujt te tjere prej druri (pa perfshire mobiljet),
  - leter kalk, leter (format A4) e karton, letra per qellime sanitare e higjenike, disa lloje ambalazhesh, etiketa, shtypshkrime, etj.
  
- Te ndara sipas grupeve, mallrat te cilat megjithe angazhimin ndaj OBT-se, do te ruajne nivelin aktual te tarifes jane:
  - pije alkoolike
  - parfume e ujra tualeti
  - artikuj kozmetike, shampo, deodorante, sapune, etj.
  - llustrues te ndryshem
  - artikuj plastike si: tuba, pipa, fleta, ambalazhe, artikuj kuzhine
  - Korniza, zburkime, arka e sendyqe, dyer e dritare prej druri
  - leter per veshje muresh, letra tualeti, ambalazhe letre e kartoni, etiketa, etj.
  - libra me piktura, plane e vizatime,
  - disa lloj çelesash elektronike e elektrike
  - giza e celiku (shufra, shkopinj, tela, profile etj.),
  - artikuj prej gize e celiku (tuba, kablllo, rezervuare e konteniere te tjere).
  - artikuj mobilerie (karrike, tavolina, mobilje te tjera),

***Efekti i pergjithshem per mallrat e mesiperme llogaritet ne rreth – 580 milion leke , ku peshen me te madhe e zene artikujt: birre, plastikat dhe artikujt prej tyre; druri dhe artikujt prej druri; preparatet pastruese.***

Ashtu sic e theksuam edhe me siper, duke vleresuar nevojten e respektimit edhe te angazhimeve te prapambetura, te paplotesuara nga vitet e kaluara, jo vetem qe u punua per saktesimin e plote te tyre, por ato jane bere pjese e projekt ligjit qe ju propozojme.

Ne kete kuader angazhimet e prapambetura te OBT-se per vitet e kaluara, sipas viteve dhe mallrave perkatese, jane si me poshte:

Per vitin 2000:

- Melci
- Qumesht
- Veze te shpendeve
- Bizele, mashurka
- Pelte, pure, recelna, e komposto prej frutave
- Pergatitje te perdorura ne industrine e pijeve
- Ushqime per kafshet
- Kripe
- Bitum nafte
- Sulfate alumini e kripera te acideve inorganike e perokside
- Ngjyrues
- Forma primare te plastikave
- Lidhjet e librave
- Paisje qeramike e qelqi per laboratore
- Ampula farmaceutike
- Artikuj kuzhine prej qelqi
- Baker e lidhje bakri, artikuj te tjere prej bakri
- Artikuj te tjere

**EFEKTI      69 milione leke**

Per vitin 2001

- Disa lloj sallamesh
- Cimcakize, cokollata, e embelsira te tjera

**EFEKTI      20 milione leke**

Per vitin 2002

- Peshku dhe kafshet guackore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jovertebrore ujore

- Fara vajore
- Vajra te ndryshem ushqimore
- Sardele e konserva
- Peptone e derivate, etj

**EFEKTI 280 milione leke**

Per vitin 2003

- Ushqyesit automatike te dokumentave
- Ushqyesit e letrave, makina perzgjedhese etj

**EFEKTI 3 milione leke**

#### **4.2. Permbajtja e kerkesave te shprehura nga biznesi dhe ministrite sektoriale**

Gjate trajtimit te kerkesave apo propozimeve, grupi nderdikasterial i eksperteve, ka vleresuar nga njera ane impaktin ne te ardhurat fiskale e te gjitha propozimeve, por nga ana tjeter edhe harmonizimin e kerkesave te importuesve me ato te prodhuesve vendas, te nxitjes se investimeve private ne ekonomi ne raport me lehtesimin e importit te produkteve te gatshme, te unifikimit te politikave tarifore ne raport me krijimin e hapësirave ne strukturen tarifore qe mund te nxise evazionin etj.

Te gjitha propozimet e biznesit dhe te Ministrive te ndryshme ne mbeshtetje te propozimeve te biznesit, u analizuan me shume kujdes mbi bazen e nje bashkesie kriteresh dhe ne konsultat e perbashketa u shkëmbyen argumentat perkatese.

Propozimet e biznesit per Paketën Fiskale u diskutuan ne bashkepunim edhe me Komisionin Keshillimor per Ceshtjet Doganore dhe Tatimore, organ i perhershëm i Keshillit Konsultativ te Biznesit. Per te gjitha propozimet e bera, ekspertet e administrates doganore dhe tatimore paraqiten argumentat dhe kunderargumentat ne varesi te propozimeve te bera, te cilat jane vleresuar gjate hartimit te kesaj pakete.

Me poshte po parashtrojme kerkesat dhe qendrimin e mbajtur per secilen nga masat e propozuara.

*Per uljen e tarifes doganore per artikujt - **ereza** qe nuk prodhohen ne vend nga 15% ne 2 perqind.*

Nga diskutimi rezultoi se, duke pasur parasysh qe prodhimi vendas per keto artikuj eshte pothuajse i pa llogaritshem, ky propozim u pranua me aresyetimin e krijimit te ne treg te nje situata te favorshme per uljen e çmimit.

Sipas perlllogaritjes nga specialistet e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave rezulton se efekti financiar nga ulja e nivelit te tarifes gjate nje viti fiskal do te jete 13,352 leke.

*Ne lidhje propozimin per uljen e tarifes doganore per artikullin **“dhjami i derrit”** nga 10% ne 2%.*

Per te mbrojtur investimet, nje pjese e konsiderueshme e te cilave eshte mbeshtetur nga skemat e kreditimit ne perpjekje per ngritjen e kesaj industrie ne vend propozimi i mesiperem nuk mund te merret parasysh sepse importi nga vendet fqinje bazuar ne tarifen e propozuar per kete produkt mund te pengoje kete industri ne zhvillim.

### **Industria e birres**

*Ulja e tarifave doganore per artikullin - **kanace alumini** - nga tarifa 10% ne 2%.*

Duke qene se ky artikull ze nje peshe te konsiderueshme ne koston e prodhimit te birres dhe pijeve te tjera jo-alkoolike me kanace dhe pijeve freskuese si Coca Cola, Fanta, Pepsi etj efekti eshte llogaritur te jete 45,187,093 leke. Efekti rezulton i madh dhe do te duhej te inkorporoheshin indikator te tjere per te balancuar ate dhe per rrjedhoje propozimi eshte menduar te mos merret parasysh, duke pare edhe lehtesirat qe krijohen nga Marreveshjet e Tregtise se Lire ne Rajon.

Por njekohesisht ne qendrimin ndaj ketij propozimi duhet te behet evidente fakti qe pjese e paketes fiskale per vitin 2004 eshte bere edhe ulja e taksës doganore per pipetat plastike –preformat nga 10 % ne 6 %, ulja e takeses doganore per enzimat, ngjyruesat, pigmentet, etketat dhe ngjitesave, tapat dhe mbyllesat e tjere, bocet e kulpres se bute etj, te cilat

perdoren gjeresisht edhe ne industrine ushqimore dhe ku perfitues ne rastin konkret jane te njejtat biznese.

*Ulja e tarifes doganore per artikullin “**lupolo**” (bocet e kulpres te bute) nga 10% ne 2 perqind.*

Nga perlllogaritjet e bera nga specialiste te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave rezulton se efekti financiar eshte rreth 3 milion leke. Nisur nga fakti qe ajo perdoret gjeresisht ne industrine e birres propozimi u pranua per nxitjen e ketij sektori ne ekonomine e vendit.

*Propozimi per uljen e tarifes doganore per “**arkat plastike**” per transportin e shisheve te birres, duhet pare e lidhur me propozimet e mesiperme te kanoceve te aluminit dhe te lendeve te para te tjera per kete industri.*

*Ne lidhje me uljen e tarifes doganore per “**bombulat e gazit**”.*

Ndonese propozimi i Ministrise se Bujqesise ka lidhje me gazin qe importohet per prodhimin e birres dhe synon nxitjen e ketij sektori te ekonomise, ky propozim ruan nivelin aktual te tarifes pasi tarifa eshte bere 2% qe ne vitin 2000.

*Per uljen e tarifes per artikullin “**krisaf alumini**” nga 10 ne 2 perqind.*

Nga llogaritja e efektit financiar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave rezulton se ndryshimi (ne grup) parashikohet te jete rreth 1,7 milion leke. Meqenese ky eshte nje produkt qe nuk mund te prodhohet ne kushtet e teknologjise qe disponojme propozimi eshte konsideruar i drejte. Gjithashtu, duke patur parasysh qe ky eshte nje produkt qe sherben si lende e pare, reduktimi i tarifes doganore do te reduktonte kostot e prodhimit per industrine ne vend.

### **Per industrine e pijeve alkoolike**

*Ulja e tarifes doganore nga 10% ne 2% per artikullin Rrush i thate per pije alkoolike – Nga diskutimi ne grupin e punes rezultoi se identifikimi ne dogana i ketyre grup produkteve kerkon nje ekspertize te madhe laboratorike e cila momentalisht nuk disponohet dhe kjo do te mund te linte hapësira per evazion.*

***Ndryshimi i tarifës doganore për produktin “Alkool etilik” nga 10% në 2%.***

Propozimi për ndryshimin e kësaj tarife doganore synon nxitjen e prodhimit të industrisë së pijeve në vend, por nga ana tjetër reduktimi i kësaj tarife do të godiste industrinë vendase të prodhimit të alkoolit etilik (sigurisht në nivelet modeste që ajo ka). Nga ana tjetër legjislacioni aktual për trajtimin e mallrave të akcizës ka krijuar një varg hapësirash nëpërmjet regjimeve të aplikuar që nuk e justifikon kërkesën për ulje.

***Ndryshimi i tarifës doganore për produktin “Sheqer i djegur”.***

Nga analiza dhe diskutimet në lidhje me këtë produkt rezultoi se ndryshimi i tarifës doganore do të binte në kundërshtim me parimin e Konventës së Sistemit të Harmonizuar brenda një grupi artikulli. Gjithashtu në kuadrin e përpjekjeve dhe luftës kundër evazionit fiskal diferencimi i tarifës të një artikulli brenda grupit mund të linte hapësira për evazion.

***Ndryshimi i tarifës doganore për artikullin “Esenca e pijeve”***

Me qëllimin e nxitjes dhe krijimit të një ambienti të favorshëm për biznesin si dhe angazhimeve të qeverisë shqiptare në marrëveshjet me OBT për vitin 2004, tarifa doganore e këtij produkti do të ulët nga 10 në 6 përqind.

***Ndryshimi i tarifës doganore për artikullin “Ngjites” (me peshe nën 1 kg)***

Tarifa doganore e këtij produkti do të ulët nga 10 në 6 përqind në kuadrin e angazhimeve të qeverisë shqiptare në marrëveshjet me OBT për vitin 2004.

*Në lidhje me kërkesën për uljen e tarifave për artikullin **Etiketa**, pranohet.*

Në kuadrin e angazhimeve që qeveria shqiptare ka nga nënshkrimi i marrëveshjeve me OBT, reduktimi i tarifës doganore për këtë produkt do të jetë 10 përqind duke filluar nga viti 2004.

***Liberalizimi i Ambalazh tetrapack***

Tarifa doganore e këtij produkti do të zbrejë në 10 përqind. Liberalizimi i kësaj tarife behet në kuadrin e angazhimeve të qeverisë shqiptare për krijimin e një klime të favorshme për biznesin dhe marrëveshjeve me OBT.

***Ndryshimi i tarifës doganore për artikullin “Bikerinat e vezeve”.***

Reduktimi i tarifës doganore këtij artikulli bëhet në kuadrin e angazhimeve të qeverisë shqiptare në marrëveshjet e OBT-se , nga 15 në 10% përqind.

Për artikujt e mesiperm, etiketa, bikerina dhe ambalazh tetrapack, megjithëse si artikujt ishin pjesë e atyre angazhimeve të OBT për të cilat u gjykua që nuk do të zbatoheshin në vitin 2004 por do të shtriheshin në vite, u morën parasysh në kuadrin e propozimeve të biznesit me ulje nga 15 në 10%.

***Rritja e tarifës doganore të cigareve të importuara nga 10% në 15% për mbrojtjen e prodhimit vendas.***

Nga analiza dhe diskutimet e shumta rezultoi se kjo kërkesë është e pa argumentuar sepse në bazë të të dhënave të një studimi të bërë gjatë vitit 2003 rezultoi se prodhimi vendas në këto industri është në kuota minimale. Të gjitha politikat fiskale të implementuara edhe gjatë viteve të mëparshme nuk kanë mundur të ndikojnë në nxjerrjen e saj nga gjendja aktuale. Njehkohësisht rritja e tarifës doganore do të rriste artificialisht barrën e importit dhe mund të rezultojë me një efekt të kundërt me pasojat e rritjes së presionit për evazion fiskal dhe kontrabandë. Nga ana tjetër është e nevojshme të nënvizojmë që në përputhje me marrëveshjen me BE, në kuadrin e anetaresimit në OBT, Shqipëria është e obliguar të respektojë detyrimin e mos rritjes së taksave doganore.

***Ulja e tarifës doganore për patate “për prodhimin e patatinave”***

Duke qenë se varieteti i këtij produkti nuk kultivohet momentalisht në vendin tonë u propozua që në Nomenklaturën e Kombënuar të kodit doganor të shtohet Kodi NC 07019020 me emërim – Për prodhimin e patatinave – tarifa doganore 10%.

Shkallëzimi i tarifës doganore specifikisht për këto produkt do të bënte në kundërshtim me parimin e Konventës së Sistemit të Harmonizuar - artikull duke sjelle për pasojë edhe një evazion të mundshme fiskal.

Ne lidhje me propozimet per zbritjen e tarifes doganore per produktin **Qumesht/krem me yndyre me shume se 21%** nga 10 perqind ne 2 perqind, nga analiza rezultoi se propozimi nuk mund te pranohet pasi do te demtonte industrine e brishte vendase ne kete sektor. Nderkohe qe ky propozim shkon ne drejtim te kundert me mbeshtetjen qe Qeveria po i jep prodhuesve dhe grumbulluesve te qumeshtit duke aplikuar skema specifike per evidentimin e TVSH.

Ne lidhje me propozimin per uljen e tarifes doganore per produktin **sheqer e melase**, e karamelizuar, nga 10 ne 2 perqind, nga analiza rezultoi se nese kjo tarife do te ulet kjo duhet te behet ne grup dhe jo per nje produkt te vetem pasi do te jete shkak per evazionin fiskal.

Ne lidhje me propozimin e uljes se tarifes doganore nga 15 perqind ne 2 perqind per **koncentrate apo pelte frutash** per perdorim ne industrine e prodhimit te lengjeve te frutave, rezulton se artikujt e mesiperm perfitojne ulje tarifash si pasoje e zbatimit te OBT te viteve te kaluara nga 15 ne 10%.

Ne lidhje me propozimin e uljes se tarifes doganore produktin **“vermut”**. Nga analiza dhe diskutimit rezultoi se ulja deri ne masen 2 perqind i kesaj tarife mund te shkaktoje demtimin e perpjekjeve per ngritjen e vreshtarise ne vend. Gjithashtu nje aresye tjeter per mos pranimin e ketij propozimi eshte se produkti trajtohet si mall akcize.

Ne lidhje me uljen e tarifes doganore per **likerna dhe tonike** nga 15 perqind ne 10 perqind, propozimi ishte pjese e angazhimeve qe ka qeveria shqiptare ne marreveshje me OBT per vitin 2004, pra ky reduktim mbetet te kete shtrirje ne vitet e mevonshme.

Ne lidhje me propozimin e uljes se tarifes doganore per produktin **duhan te homogjenizuar nga gjethe e prere holle** mbetje apo pluhur nga 10 ne 2 perqind, nga analiza rezultoi se propozimi nuk mund te pranohet pasi do te binte ndesh me parimin e unifikimit te tarifave brenda nje grupi - artikulli. Shkallezimi i kesaj tarife do te mund te linte shkak evazion fiskal.

Propozimi per uljen e tarifes doganore te produktit **kripe dhe klorurnatriumi** nga 15 ne 2 perqind, do te zbatohet pjeserisht sipas angazhimeve te OBT te viteve te kaluara, ne nivelin 10%.

Ne lidhje me kete produkt mund te themi se ekziston industria vendase e perpunimit dhe ulja e tarifes ne nivelin e kerkuar do ta barazonte me kripen per perdorime industriale.

Ne lidhje me propozimin per uljen e tarifes doganore te produktit **fosfate** nga 2 ne 0 perqind, nga analiza rezultoi se nuk eshte argumentuar dhe ulja vetem e ketij produkti, do te binte ndesh me parimin e unifikimit te tarifes brenda nje grup – artikulli. Vlen te nenvizohet qe niveli 2 % i takses doganore eshte realisht nje nivel teper i ulet.

Ne lidhje propozimin e biznesit per uljen e tarifes doganore per produktin mbetje, te produktesh shtese **polimerizimi** (prej akrilik, etilen, stiren).

Tarifa doganore per kete produkt do te ulet nga 10 ne 5 perqind ne kuadrin e angazhimeve te qeverise shqiptare ne marreveshjet me OBT.

Ne lidhje me propozimin e biznesit per uljen e tarifave doganore per grup produktet **“film prej polietileni jocelular”**

Per produktin e latpermendur aplikohet nje tarife doganore zero nga Marreveshjet e Tregtise se Lire.

Ne lidhje me propozimin per uljen e tarifave doganore per grup produktet **leter dhe karton**, nga analiza rezultoi se ne baze te marreveshjeve me OBT keto mallra perfitojne ulje te tarifave sipas grupeve nga 10% dhe 2%, ne 0%.

Ne lidhje me propozimet per uljen e tarifes doganore nga 10 ne 2 perqind per grup produktet **suprina lekure** etj (kodi 6406-1-9 i nomenklatures) nga analiza rezultoi se propozimi nuk mund te pranohet. Aktualisht ne vend kemi te zhvilluar nje industri vendase per trajtimin dhe perpunimin e lekurave jo vetem te vendit por edhe te lekurave te pa perpunuara me burim importin. Mbi kete llogjike pjese e kesaj pakete fiskale jane bere edhe reduktimet e tarifave doganore nga 10% ne 6 % per preparatet qe perdoren ne procesin teknologjik te perpunimit te lekureve, me qellim nxitjen e industrise perpunuese

ne raport me importin e lekureve te gatshme. Nga ana tjetër ne perputhje me Marreveshjet e Tregtise se Lire ky produkt perfiton.

Ne lidhje me propozimin e uljes se tarifes doganore per **grup artikujt gozhde, pineske, artikuj alumini te derdhura** (grup kodi 7616 i nomenklatures), nga 15 ne 2 perqind, nga analiza rezultoi se propozimi per kete ky grup – produkti nuk mund te pranohet pasi nuk ploteson kriterin e shkalles se transformimit te produktit. Nderkohe ky produkt trajtohet me Marreveshjet e tregtise se lire dhe do te reduktohet ne baze te marreveshjeve te OBT ne vitin 2005.

Ne lidhje me propozimin per uljen e tarifes doganore per **mishin e ngrire** nga 10% ne 2 %, grupi i eksperteve duke vleresuar nevojën e mbeshtetjes te investimeve private ne fushen e blegtorise te mbeshtetura nga programe specifike qe qeveria ka implementuar se bashku me donatorët e huaj si dhe faktin qe edhe nga Marreveshjet e Tregtise se Lire ato jane konsideruar si produkte te mbrojtura, u gjykua qe te mos pranohet.

Ne lidhje me propozimet per tarifën doganore **per birren e bere nga malti**, propozime qe jane ne pozicione te kunderta nga prodhuesit dhe importuesit, grupi i eksperteve duke mbajtur ne konsiderate nevojën e respektimit te angazhimeve te OBT-se propozon qe te reduktoje nivelin e tarifës nga 20% ne 10%. Respektimi i ketij angazhimi ishte dhe nje nga pikat me te prehta gjate raundit te fundit te negociatave me BE-ne.

Ne lidhje me propozimin per unifikim e tarifës doganore per te gjitha formatet e letres – letra A 4, nga ekspertet u pranua ne nivelin 2%, duke marre ne konsiderate edhe detyrimin qe buron nga angazhimet ne OBT.

Ne lidhje me propozimet per uljen e tarifës doganore **per pelhurat tekstilet dhe shajakun**, grupi i eksperteve duke zbatuar nje klasifikim te sakte tarifor vetem per ato lende qe perdoren ne industrine e prodhimit te katramase, pranoi nje ulje te nivelit nga 10 ne 2%.

Ne lidhje me propozimin per reduktimin e tarifes doganore nga 2 % ne 0 % **te mbyllesave, tapave dhe kapaqeve metalike**, grupi i eksperteve duke marre ne konsiderate qe me paketen fiskale te vitit 2003 eshte pranuar dhe implementuar ulja nga 10% ne 2 % per kete grup artikujsh si dhe faktin qe niveli 2 % eshte niveli me minimal i tarifes doganore nuk e miratoi kete propozim.

Ne lidhje me propozimin per uljen e tarifes doganore per artikullin **“Leter Greaseproof”**, grupi i eksperteve nisur nga fakti qe me paketen fiskale te vitit 2003 niveli i tarifes eshte ulur nga 15 % ne 2 % per kete grup si dhe ne analize te gjitha qendrimeve te mbajtura, niveli 2 % eshte nivel teper i ulet, nuk e miratoi propozimin.

**Ne lidhje me propozimet e Keshillit te Organizatave te Punedhenesve Shqiptar, Shoqates Kombetare te Mbrotjes se Tregtareve dhe Tregut dhe Shoqates se Ndertuesve.**

Nga keto organizata u propozuan ndryshime per taksat vendore ne lidhje me transferimin e pasurise se patundshme si dhe taksen mbi ndertimet e reja qe prekin infrastrukturen.

Lidhur me keto propozime nuk eshte rene dakort pasi ne teresi ato bien ne kundërshtim me kerkesat e ligjit “Per Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” si edhe me strategjine e decentralizimit dhe autonomise vendore.

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit ka paraqitur qendrimin e saj argumentues per mospranimin e propozimit duke sugjeruar edhe nevojën e diskutimit me shoqaten e Kryetareve te Bashkise dhe te Kryetareve te Komunave. Ne keto kushte propozimi nuk eshte bere pjese e paketes fiskale.

**Ne lidhje me propozimet e Keshillit Agroshqiptar te Biznesit.**

Propozimi per heqjen e akcizave te karburanteve per lendet djegese dhe lubrifikatet per makinat bujqesore, serat me ngrohje dhe linjat e agroperpunimit.

Ky propozim u mbeshtet edhe nga Ministria e Bujqesise.

Nga diskutimi dhe analiza ne lidhje me kete propozim, nga grupi I punes per paketen fiskale u gjykua si e pa mundur teknikisht pasi destinacioni i ketij karburanti pa akcize per

perdorim per makinerite bujqesore dhe jo per makineri apo automjete te tjera nuk mund te kontrollohet.

Efekti i konsumit te karburantit te makinerive bujqesore eshte rreth 500 milion leke (pa llogaritur ketu efektin e evazionit). Po keshtu keto masa duhet te korrelohen me politika te cilat ulin evazionin ne sektorin e bujqesise (si psh perfitojne nga akciza e konsumit te karburantit bujqit qe paguajne taksen e regjistrimit te automjetit, taksen e tokes bujqesore etj). Keto sugjerime mbeshteten nga argumenti se sipas te dhenave te regjistrimit te mjeteve rezulton se makinerite bujqesore aktualisht nuk e paguajne fare kete takse.

Ne vijim te diskutimeve, i eshte kerkuar pergatitja e nje studimi me te plote, duke pare edhe mundesine e implementimit pilot te kesaj politike.

Ne diskutimet e grupit te punes jane marre ne shqyrtim edhe propozimet per nje sere artikujsh, ku nje pjese e konsiderueshme perfitojne nga implementimi i shkallezuar i angazhimeve te OBT-se apo edhe nga Marreveshjet e Tregtise se Lire te nenshkruara deri tani.

#### ***Propozimi i biznesit per shkallezimin e nivelit te TVSH-se:***

Kerkesa e biznesit per shkallezimin e Tatimit mbi vleren e shtuar me 2 nivele u konsiderua i perealizueshem pasi ne pergjithesi edukata fiskale e bizneseve ndaj ligjeve fiskale eshte ende e ulet. Gjithashtu mbajtja e thjeshtezuar e ligjit me nje nivel duke pasur parasysh edhe kapacitetet e administrates tatimore, nivelin e ulet te informatizimit dhe infrastrukturen fiskale ne pergjithesi eshte me realist dhe adekuat ne kushtet e sotme te sistemit fiskal. Shkallezimi ne dy nivele duke marre ne konsiderate per sa me siper do te krijonte probleme serioze ne menaxhimin e kesaj takse e per rrjedhoje edhe te situates fiskale.

#### ***Propozimi i biznesit ne lidhje me tatim – fitimin te shkallezuar sipas zonave:***

Propozimi per shkallezimin e nivelit te tatim fitimit sipas zonave te ndryshme te vendit i diskutuar nga specialistet e Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve me grupin e biznesit nuk mund te aplikohet per disa arsye. Se pari, ky shkallezim do te krijojte kundershti legjislative dhe hapesine per evazion fiskal. Psh, nje kompani mund te rregjistrohet ne nje zone me nivel te ulet tarifar dhe te kryeje aktivitet ne zona te tjera me nivel me te larte. Se

dyti, norma e tatimit mbi fitimin eshte me e ulet sesa mesatarja e vendeve te rajonit dhe performanca e mbledhjes se saj ne te gjitha Shqiperine vleresohet ende e ulet, per rrjedhoje mendohet se nuk ekzistojne kushtet per uljen e nivelit tarifor dhe shkallezimit.

Ne mbyllje te parashtrimit, do te donim te nenvizionim faktin qe pjese e kesaj pakete fiskale jane bere edhe implementimi i masave te cilat sigurojne nje impakt real ne drejtim te politikave sociale ne perputhje me prioritetet dhe objektivat e Strategjise se Zhvillimit Ekonomik dhe Social. Ne kete kuader jane reduktuar tarifat doganore per nje nomenklature te gjere te artikujve te higjenes personale te perditshme, te artikujve te perdorimit te higjenes shtepiake, te lodrave te femijve, te artikujve shkollore, te artikujve sterile te perdorimit te gjere ne shendetesi si marrja ne konsiderate e propozimit te bere per heqjen e detyrimit te pagimit te TVSH per sherbimet arsimore parauniversitare dhe universitare qe jepen nga instutucionet publike dhe private. Kjo mase e fundit synon te zgjeroje pjesmarrjen e investimeve private ne sektorin e arsimit jo publik, te ofrimit te nje sherbimi me cilesor te tij ne kushtet e pamundesise se buxhetit te shtetit per te perballuar kerkesat gjithnje ne rritje per zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrjetit ekzistues te arsimit parauniversitar dhe universitar.

**5. Lista e Projekt-akteve ligjore te paketes fiskale per vitin 2004**

- 5.1** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”.*
- 5.2** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7928, date 27.04.1995 “Per tatimin mbi vleren e shtuar”, me ndryshimet perkatese.*
- 5.3** Projekt Ligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë”.*
- 5.4** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8976, date 12.12.2002 “Per akcizat” .*
- 5.5** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8977, date 12.12.2002 “Per sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.*
- 5.6** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8701 date 1.12.2000 “Per lojerat e fatit, kazinote dhe hipodromet”.*
- 5.7** Projektligji *“Per miratimin e Nivelit te Tarifes Doganore”, plotesimi i detyrimeve me OBT dhe Marreveshjeve te Tregtise se Lire, si dhe reflektim i kerkesave te biznesit.*
- 5.8** Projekt ligji *“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 “Per sigurimet shoqerore”.*

**Projekt Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.**

Ky projektligj është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe është monitoruar nga grupi i punës në Ministrinë e Financave. Ndryshimet dhe shtesat e paraqitura në këtë projekt-ligj synojnë rregullimin e boshllëqeve eliminimin e keqinterpretimeve, reduktimin e evazionit fiskal, si dhe përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave administrative si për tatimpaguesit ashtu edhe për administratën tatimore dhe konkretisht:

Është nderhyrë në Kreun II "Administrata Tatimore" ku janë përcaktuar rregulla me të qarta lidhur me organikat dhe pagat, me mënyrën e rekrutimit të personelit në administratën tatimore, me mënyrën e motivimit me të mirë të saj, me procedurat e përcaktimit të niveleve të karrierës.

Vendosja e detyrimit për administratën tatimore për të informuar publikun për ligjet e reja tatimore, shtesat apo ndryshimet në to dhe aktet nenligjore në zbatim të tyre, si dhe regjistrimi i ortakeve, direkt në organet tatimore duke paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur, propozim ky i bërë nga shoqatat e biznesit.

Lidhur me Organizatat Jo-Fitimpruese është vendosur detyrimi për tu regjistruar në organet tatimore. Kur këto organizata përveç aktivitetit kryesor, kryejnë edhe aktivitete të tjera të karakterit ekonomik, janë të detyruar të regjistrojnë veças këto aktivitete në organet tatimore, njësoj si çdo tatimpagues tjetër që ushtron veprimtari ekonomike.

Rishikimi i “Metodave alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor” synon të vendosë rregulla me të qarta për vlerësimin tatimor. Duke reduktuar abuzivitetin apo subjektivizmin e administratës tatimore.

Është ripare neni 46 "Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore" duke ndryshuar radhën e marrjes së këtyre masave. Një gjë e tillë është diktuar nga fakti se në praktike për tatimpaguesin që nuk paguajnë detyrimet tatimore është me efikasë vendosja fillimisht e masës së mbylljes së perkohshme të veprimtarisë së saj gjatë apo sekuestro.

Limiti i lejimit të kryerjes me leke në dorë të transaksioneve nga 1 milion leke është ulur në 300.000 leke, në kuadrin e masave për reduktimin e ekonomisë informale dhe bashkë me këtë edhe të kufizimit të CASH-it.

Kemi konsideruar të arsyeshme edhe vendosjen e një afati për kryerjen e vlerësimit tatimor në rastin e një kontrolli, gjë që nuk ka ekzistuar më parë.

Është dhënë drejta organeve tatimore për të publikuar të dhëna krahasuese midis tatimpaguesve në bashkëpunim me Dhomen e Tregtisë dhe Industrisë.

Efektet financiare në buxhet do të jenë pozitive si rrjedhojë e përmirësimit të procedurave.

**Projekt ligji “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”**

Ndryshimet e propozuara në Kreun e parë dhe të dytë të ligjit janë bazuar në probleme të evidentuara nga zbatimi i deri tanishëm i ligjit, lidhur me burimin e të ardhurave dhe me të ardhurat e tatueshme, si dhe ne propozimet e shoqatave te biznesit dhe degët e tatimeve.

Ndryshimet në pasqyrën e tatimit mbi pagat qe ka të bëjë me aplikimin e dy tarifave të reja, 30% dhe 35% për pagat mujore më të larta se, respektivisht, 300 mijë lekë dhe 400 mijë lekë per te mos lejuar shmangien e tatimit mbi dividendet.

Ndryshimet synojne unifikimin e tatimit në burim në nivelin 10% (nga 15% që ishte për disa lloje pagesash dhe për pagesa që i bëheshin jo residentëve), duke shmangur diskriminimin, por edhe duke lehtësuar procedurat administrative për bizneset dhe për administratën tatimore.

Projekti synon forcimin e masave qe lidhen me detyrimet për deklarimin e tatimit mbi të ardhurat personale si dhe me kundravajtjet administrative dhe bëhen për të reflektuar dhe uniformizuar procedurat dhe sanksionet që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 9136, datë 11. 9. 2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”.

Njekohesisht ne qender te vemendjes ka qene edhe përmirësimi i administrimit dhe luftimi i evazionit dhe fallsifikimeve, duke përqëndruar në organet tatimore prodhimin dhe shpërndarjen e faturës së thjeshtë tatimore nepermjet shteses se nenit 32/5 te ligjit baze.

Ndryshimi i shkallës tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, i cili ndihmon: se pari për një trajtim më të drejtë të aktiviteteve të ndryshme, në rritjen e të ardhurave nga ky tatim, dhe stimulimin e regjistrimit te subjekteve në tatimin mbi vlerën e shtuar.

Përmirësimet e bëra ne lidhje me mbajtjen e tatimit në burim” kanë të bëjnë me saktësime dhe përmirësime të diktuar nga eksperiencia e deritanishme në administrimin e këtij tatimi. Gjithashtu janë përjashtuar nga tatimi në burim pagesat që i bëhen personave jo-rezidentë për transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

**Projekt ligji “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7928, date 27.04.1995 “Per tatimin mbi vleren e shtuar”, me ndryshimet perkatese**

Ndryshimet dhe shtesat ne kete projekt-ligj konsistojne kryesisht ne disa perjashtime nga Tatimi mbi Vleren e Shtuar si:

Perjashtimin nga TVSH e qeradhenies se ndertesave prone publike sepse perfshirja e ketyre institucioneve ne TVSH, per shkak te qarkullimit, e denatyron dhe deformon transaksionin, aq me teper qe shperndarja dhe derdhja ne buxhet e te ardhurave qe vijne nga kjo qeradhene , rregullohet me akt ligjor te vecante.

Ne mbeshtetje te zhvillimit te politikave sociale dhe uljes se varferise, eshte bere perjashtimi nga TVSH i sherbimeve arsimore parauniversitare dhe universitare i cili jepet ne nenin 24/1, per institucionet publike dhe private.

Deri ne kete moment per keto lloj sherbimesh nuk llogaritet dhe paguhet TVSH kur jepen nga institucione publike, ndersa llogaritet dhe paguhet TVSH kur keto lloj sherbimesh furnizohen nga institucione arsimore private. Megenese TVSH eshte tatim mbi konsumin, ajo rendon mbi nxenesit dhe studentet qe ndjekin keto shkolla duke renduar shpenzimet e tyre.

Projekti synon te perjashtoje nga vlera e tatueshme e mallrave te importuara shpenzimet e ngarkim-shkarkimit, zhdoganimit, parkimit, spedicionimit etj. Keto lloj shpenzimesh duke u perfshire ne vleren e tatueshme te mallrave importuara rrisnin artificialisht detyrimet e TVSH-se ne momentin e importimit.

Me ndryshimet e bera ne ligjin "Per lojrat e fatit, kazinove dhe Hopodromeve" lindi edhe detyrimi per perjashtimin nga TVSH -ja te subjekteve te licencuara sipas ketij ligji.

Permiresimi i masave te kontrollit nepermjet perfshirjes ne fature te informacionit te detyrueshem per transportuesin e mallit: emrin, adresen, NIPT-in, targen e mjetit, si dhe destinacionin e mallit eshte nje tjetër ndryshim i bere ne kete ligj.

Kjo behet me qellim ngushtimin e shtigjeve per evasion fiskal, identifikimin e firmave ose individeve transportues per ti perfshire ne qarkun e personave te tatueshem.

Me ane te ketyre ndryshimeve eshte synuar konsolidimi i marredhenieve te mira me biznesin nepermjet rishqyrtimeve, cka zvogelon mundesite e organeve tatimore per te abuzuar me afatet ligjore per berjen e nje rishqyrtimi tatimor.

Gjithashtu ne kete fryme eshte dhe unifikimi i afatet dhe rregullat e rimbursimit si pasoje e rishqyrtimeve sipas Ligjit te TVSH-se me ate te Ligjit “Per procedurat tatimore ne RSH”.

**Projekt ligji “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8976, date 12.12.2002 "Per akcizat”**

Projekt-ligji eshte ndertuar duke marre parasysh nje sere propozimesh te bera nga shoqatat e biznesit sic eshte ai i perjashtimit nga akciza ne import te karburanteve qe perdoren per nevoja te zbulimit dhe venies ne shfrytezim te zonave nafte mbajtese nga subjektet qe kane marreveshje me Qeverine Shqiptare.

Shtesat dhe ndryshimet e perfshira ne te jane si me poshte:

Diferencimi i nivelit të akcizës për llojet e ndryshme të benzinës në kuadrin e programeve të Qeverisë për mbrojtjen e ambjentit si dhe për të plotësuar kriteret e vendosura nga Bashkimi Europian për dhënjen e kredive për ndërtimin e rrugëve.

Rritja e akcizës së naftës nga 50% në 65% si rezultat i konsolidimit fiskal të takses Durrës-Kukes.

Heqja nga lista e akcizës e gazit të lëngshëm si për automjetet ashtu edhe për përdoruesit shtëpiake sepse me kapacitetet tona administrative është e pamundur të shmangen abuzimet dhe evazioni fiskal në lidhje me to.

Gjithashtu është bërë heqja nga lista e mallrave të akcizës e “parafinës” për të ndihmuar dhe stimuluar prodhuesit vendas të qirinjve.

Lejimi i lëvizjes së alkoolit nga një magazinë tatimore e miratuar në një magazinë tjetër tatimore të miratuar nën regjimin e pezullimit tatimor, për të mos lejuar diskriminimin e prodhimit vendas të ketij lloji artikulli.

Trajtimin e importuesve të maltos për prodhimin e birrës. Kjo dispozitë është futur për të luftuar abuzimet e bëra deri tani nga importues “fantazëm” të maltos.

Në këto kushte importimi i maltos pa paguar akcizë në import do të jetë i lejuar vetëm për prodhuesit e autorizuar të birrës.

Njekohesisht projekti synon forcimin e masave administrative kundër shkeljeve për mbajtjen, transportin ose shitjen e mallrave të akcizës pa pullë duke i njohur të drejtën e organeve tatimore për të konfiskuar mallrat e akcizës.

**Projekt ligji “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8977, date 12.12.2002 "Per sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.**

Heqja e taksës së rrugës Durrës –Kukes si domosdoshmëri e detyrimeve që lindin nga anetaresimi i Shqipërisë në OBT, dhe kusht i BE-së për heqjen e taksave me natyrë të njëjta me taksën doganore (kusht i cili përfshin edhe taksën e rrugës Durrës - Kukes), të cilat do të çojnë në uljen e barrës fiskale për tatimpaguesit që importojnë mallra duke dhënë indirekt ndikimin e tyre edhe në uljen e çmimeve të mallrave të konsumit është edhe ndryshimi kryesor i bërë ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" nepermjet këtij projekt-ligji.

Për të mbështetur zhvillimin e infrastruktures rrugore si dhe për të mirëmbajtur rrugët nacionale me këte projektligj propozohet të vendoset taksa e qarkullimit rrugor. Kësaj takse do t'i nënshtrohen të gjithë përdoruesit e automjeteve por ajo do të jetë e diferencuar në varësi të kategorive të automjeteve.

Për autoveturat është propozuar që të jetë 7 mijë leke, ndërsa për mjetet e tjera si autovetura me më shumë se (4+1) vende, mikrobuze, autobuze të çdo lloji dhe kamione të çdo tonazhi 15 mijë leke.

Efekti financiar në rritjen e të ardhurave është rreth 1.45 miliard leke.

Në projektligj është parashikuar ulja e përqindjes së agjentit tatimor nga 22% në 12%. Sepse konsolidimi i vjeljes së kësaj takse gjatë u arrit gjatë periudhës 2001-2003 dhe nevoja e vendosjes së parimeve të njëjta për agjentet fiskale bëhet e evidente. Drejtimit e përdorimit të të ardhurave nga agjenti fiskal do vazhdojnë të jenë mekanizimi, informatizimi dhe shpenzimet e tjera administrative.

Në këte projekt është propozuar që të bëhen disa shtesa dhe ndryshime në lidhjen Nr.6 “Taksat për shërbimet e radiotelekomunikacionit” që konsistojnë në vendosjen e disa taksave për disa shërbime të reja, të futura apo që priten të futen në tregun shqiptar si shërbimet celulare EGSM, DCS 1800, IMT-2000 si dhe të shërbimeve wireless.

**Projekt ligji "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8701 date 1.12.2000 "Per lojerat e fatit, kazinote dhe hipodromet"**

Ligji per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet ka sjelle nje sere ndryshimesh dhe shtesash te cilat konsistojne kryesisht ne:

- Rrijen e te ardhura fiskale nga keto aktivite ne buxhetin e shtetit.
- Mbrojtjen e dhe amortizimin e kosos sociale qe i shkaktjne kete lojra konsumatorit (lojtareve).

Dy synimet e siperpermendura jane baza e akteve ligjore qe rregullojne legjislacionin e lojrave te fatit dhe basteve sportive ne te gjitha keto vende duke i trajtuar keto lojra kryesisht si nje burim te ardhurash per buxhetin dhe duke u perpjekur qe te kufizojne demin social qe ato mund t'u shkaktjne pjesemarresve. Per kete arsye ne te gjitha keto vende barra fiskale e aplikuar mbi kete kete kategori biznesi eshte dyfish me i larte dhe progresiv se barra fiskale qe aplikohet ne aktivite te tjera biznesi.

Për vetë natyrën specifikën të zhvillimit të këtij aktiviteti, qe nuk kane asnje impakt ne rritjen ekonomike, ku përlllogaritja e xhiros dhe e fitimeve të shpërndara nga kompanitë (sidomos në lojrat sportive të fatit) është teknikisht i pamundur, propozohet në këtë paketë modeli i tatimit me kuota fikse. Gjithashtu ne draftin e paraqitur parashikohet si mase mbrojtese per konsumatorin (lojtarin) percaktimi i detyrueshem i ndarjes se fitimit per lojtarët ne masen nga 60 deri ne 75 perqind per lojtarin dhe 40 deri 25 perqind per organizatorin e lojrave.

Tabela e meposhteme pasqyron qarte ndarjen e xhiros per secilen loje midis organizatorit dhe lojtareve.

Loja	Lojtari	Organizatori
loto, keno, proto dhe xhoker	Jo me pak se 60 perqind	Maksimumi 40 perqind
Lojra fati sportive – konkurs	Jo me pak se 60 perqind	Maksimumi 40 perqind
Lojra fati sportive – Baste	i pa percaktuar	i pa percaktuar
Lojra fati elektronike me fitim ne cast	Jo me pak se 75 perqind	Maksimumi 25 perqind
Llotari	Jo me pak se 60 perqind	Maksimumi 40 perqind
Loja	Lojtari	Organizatori

Per makinat elektronike me fitim ne cast me me shume se nje vend (ruleti), do te aplikohet nje takse 2,000,000 leke ne muaj per makine. Kjo norme eshte vendosur duke patur parasysh dy parimet e lartpermendura. Per lojrat e tjera tarifat do te jene:

**Lojrat Aritmetike**

- Loto, keno, proto dhe xhoker paguan tatim per lojrat e fatit 20 % mbi volumin e qarkullimit gjithsej
- Lojes bingo, paguan tatim per lojrat e fatit ne masen 200. 000 (dyqind mije) leke ne muaj per çdo sallë.

**Lojrat e fatit sportive:**

- Loja konkurs per parashikimet sportive, paguan tatim mbi lojrat e fatit 20% mbi volumin e qarkullimit gjithsej
- Loja e bastit sportiv, paguan tatim mbi lojrat e fatit ne masen 10.000.000 leke në vit dhe një shumë fikse prej 100.000 leke në vit për çdo pike shitje.

**Lojrat e fatit elektronike me fitim ne çast:**

- Lojrave elektronike me fitim ne cast, paguan tatim per lojrat e fatit ne masen 25.000 leke ne muaj per çdo makine.
- Lojrave elektronike me fitim ne cast qe ka ne funksion kompjuter ose makine elektronike me me shume se nje vend per lojtar 2.000 000 lekë ne muaj per çdo kompjuter ose makine.

**Lojrat e fatit te kategorise llotari:**

- Llotari e castit dhe llotari per te cilen hidhet short, paguan tatim per lojrat e fatit 20% mbi volumin e qarkullimit.

**Taksa e regjistrimit per kazinote**

- Taksen kombetare te regjistrimit te kazinose prej 30.000.000 (tridhete milion) leke per secilen kazino, takse e cila paguhet vetem nje here me marrjen e lejes.
- Tatimpaguesit qe ushtrojne veprimtari ne kazino, sipas ketij ligji, nuk i nenshtrohen tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi vleren e shtuar.
- Tatimpaguesit qe ushtrojne veprimtari ne kazino, paguajne 20% tatim mbi volumin e qarkullimit gjithsej te realizuar nga lojrat e kazinose.

**Detyrimi tatimor per Hipodromet**

- Taksa kombetare te regjistrimit per hipodromet prej 20.000.000 (njezet milion) leke, e cila paguhet vetem nje here me marrjen e lejes.
- Detyrimin tatimor per hipodromet 20% mbi volumin e qarkullimit gjithsej te realizuar.

Po në këtë kuadër është vlerësuar si domosdoshmëri, shtypja e përqendruar dhe e mbikqyrur nga shteti e biletave, skedinave etj në një pjesë të madhe të rasteve (në rastin e lojrave ku tatimi nuk është fiks, por vendoset mbi xhiron). Përveç matjes më të saktë të xhiros kjo gjë do të reflektojë automatikisht jo vetëm më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit por edhe shmangien e abuzimeve lidhur me shpërndarjen e fitimeve tek pjesëmarrësit në lojrat e fatit.

Persa i perket licensimit te shoqerive per kazino dhe hipodrome eshte futur sistemi i licensimit ne dy faza.

Eshte pare gjithashtu e arsyeshme qe format e shoqerive te kazinove te jene shoqeri: me kapital te perbashket, shteterore, private - vendase apo te huaja, po keshtu edhe konkurimi per marrjen e licences per kazinote.

Efektet financiare perlogariten te arrijne ne vleren **0.7miliard leke.**

**Projektligji "Per miratimin e Niveleve te Tarifes Doganore",**

Ligji nr. 8981 i miratuar ne date 12.12.2002, eshte ligji baze dhe aktual per nivelet tarifore te mallrave, mbeshtetur ne kodifikimin e mallrave sipas Sistemit Harmonik 2002, dhe versionit 8 shifror te Nomeklatures se Kombinuar identik me versionin e BE.

***Per vitin 2004 jane rreth 1000 kode tarifore, tarifa e te cileve reduktohet ne nivele te ndryshme.***

Nderkohe per disa grup mallrash si kimikate organike, pleheruesit, agjente organike me veprim te siperfaqshem, lloje ngjitesish, bombula gazi te lengshem, mallra fotografike dhe kinematografike, produkte te ndryshme kimike, forma primare plastike niveli aktual i tarifes doganore i zbatuar eshte me i ulet sesa angazhimi sipas OBT-se per vitin fiskal 2004.

***Te ndara sipas grupeve mallrat qe perfitojne reduktim sipas skedulit jane:*** birra, ekstrakte me origjine vegjetariane, estere, lende ngjyrosese, pigmente, smalte, glazura e bojra glazure te perdorura ne industrine e qeramikes e te qelqit, substanca albuminoidale, ngjitesa te ndryshem, perzierje te substancave aromatike per industrine e pijeve, shkrepese, mbetje, kthime dhe monofilamente prej plastike, trungje halore e jo halore, qymyr druri, artikuj druri, leter (kryesisht per lende te pare), disa lloje kartonesh, ambalazhesh prej letre e kartoni, instrumenta (sharra, trapane).

***Te ndara sipas grupeve mallrat qe perfitojne reduktim te pjesshem (jo ne nivelin tarifar sipas skedulit te OBT-se) per te cilat shtrirja e reduktimit zgjatet ne vite jane:*** vajra thelbesore, preparate pastruese e detergjente, artikuj plastike si :tuba pipa prej polimereve, fleta rimesoje, panele e artikujt te tjere prej druri (pa perfshire mobiljet), leter kalk, leter (format A4) e karton, letra per qellime sanitare e higjenike, disa lloje ambalazhesh, etiketa, shtypshkrime etj.

***Te ndara sipas grupeve mallrat megjithe angazhimin ndaj OBT-se, do te ruajne nivelin aktual te tarifes*** pije alkoolike, parfume dhe solucione tualeti, artikuj kozmetike, shampoo, ilustrues te ndryshem, artikuj plastike si: fleta, ambalazhe, artikuj kuzhine, korniza, zbukurime, arka e senduqe, dyer e dritare prej druri, leter per veshje muri, libra me piktura, plane e vizatime, disa lloj çelesash elektronik e elektrik, giza e celiku (shufra, shkopinj, tela, profile etj), artikuj prej gize e celiku (si tuba, kablllo, rezervuare e konteniere te tjere), artikuj mobilerie (si karrige, tavolina, mobilje te tjera).

***Efekti i pergjithshem per mallrat e mesiperme llogaritet ne rreth – 580 milion leke , ku peshen me te madhe e zene artikujt: birre, plastikat dhe artikujt prej tyre; druri dhe artikujt prej druri; preparatet pastruese.***

Duke vleresuar nevojën e respektimit edhe te angazhimeve te prapambetura, te paplotesuara nga vitet e kaluara, jo vetem qe u punua per sakesimin e plote te tyre, por ato jane bere pjese e projekt ligjit qe ju propozojme. Ne kete kuader sipas angazhimeve duke filluar nga viti 2000 mallrave perkatese, jane si me poshte:

**Per vitin 2000, artikujt jane:** melci, qumesht, veze te shpendeve, bizele, mashurka; pelte, pure, recelna e komposto prej frutave; solucione te perdorura ne industrine e pijeve, ushqime per kafshet, kripe, bitum, nafte, sulfate alumini e kripera te acideve inorganike e perokside, ngjyrues, forma primare te plastikave, lidhjet e librave, paisje qeramike e qelqi per laboratore, ampula farmaceutike, artikuj kuzhine prej qelqi, baker e lidhje bakri, artikuj te tjere prej bakri, te tjere. **Efekti 69 milione leke.**

**Te vitit 2001, artikujt jane:** disa lloj sallamesh, cimcakize, cokollata, e embelsira te tjera. **Efekti 20 milione leke.**

**Te vitit 2002, artikujt jane:** Peshku dhe kafshet guackore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jovertebrore ujore, fara vajore, vajra te ndryshem ushqimore, sardele e konserva, peptone e derivate, etj. **Efekti 280 milione leke.**

**Te vitit 2003, artikujt jane:** Ushqyesit automatike te dokumentave, Ushqyesit e letrave, makina perzgjedhese etj. **Efekti 3 milione leke.**

Ndersa nga grupi i propozimeve te biznesit te cilat jane konsideruar te drejta, por qe nuk kane perfituar nga OBT (si me siper) dhe marreveshjet e tregetise se lire me vendet e rajonit e me gjere jane:

- Disa lloje erezash te ndryshme (arre e lekure hindi te cilat nuk prodhohen ne vend dhe perdoren ne industrine e prodhimit te sallamit) - **efekti 0.01 milion Leke,**
  - Lupuline (jane mikroganizma per prodhimin e majase se birres) - **efekti 3.7 milion Leke**
  - Shajak prej materialeve tekstile jo i veshur apo laminuar (qe perdoret ne industrine e prodhimit te katramase) - **efekti 0.4 milione leke**
  - Krisafe alumini me trashesi te ndryshme (qe perdoren per ambalazhimin e produkteve farmaceutike, industrine ushqimore) - **efekti 1.8 milion Leke**
- (EFEKTI total nga ky grup eshte rreth 6 MILION LEKE.)**

**Si perfundim efekti financiar total per te gjitha artikujt per te cilet niveli tarifor do te reduktohet per vitin 2004 do te jete 958 milion LEKE.**

**6. Efektet e Paketës së re Fiskale 2004 në Buxhet**

**6.1. Efektet e Paketës Ligjore të Tatimeve**

<b>Paketa Fiskale</b> <i>Ne milionë lekë</i>	<b>Efekt</b> <b>(pozitiv)</b>	<b>Efekt</b> <b>(negativ)</b>
1. Taksa e rrugës Durrës – Kukës		3,300
2. Taksa për automjetet	1,450	
3. Ndryshimi në akcizat	1,850	
4. Efektet e Ligjit për lojrat e fatit	700	
<b>TOTALI NE BUXHET</b>	<b>4,000</b>	<b>3,300</b>
<b>TOTALI I EFEKTEVE – POZITIV</b>	<b>700</b>	

**6.2. Efektet e ndryshimeve në Nivelin e Tarifave Doganore.**

Si rezultat i respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshjet e Tregtise së Lire me vendet e rajonit, Marrëveshja me OBT-ne, kërkesave të biznesit e ministrive sektoriale, përlogariten efekte si më poshtë:

<b>Paketa Fiskale - Efektet e MTL-ve</b> <i>Ne milionë lekë</i>	<b>Efekt</b> <b>(pozitiv)</b>	<b>Efekt</b> <b>(negativ)</b>
Me Bosnje Hercegovinen		16.7
Me Kroacine		225,44
Me Rumanine		50
Me Maqedonine		174,8
Me Bullgarine		317,4
Me Jugosllavine		139
Me Kosoven		25,6
Me Moldavine efekti është i pallogaritshëm (nivel i ulët shkëmbimi tregtar)		
<b>TOTALI NE BUXHET</b>		<b>949,2</b>
<b>TOTALI I EFEKTEVE – NEGATIV (në milione LEKE)</b>		

<b>Paketa Fiskale - Efektet e Propozimeve të Biznesit, dhe të Ministrive Sektoriale</b> <i>Ne milione leke</i>	<b>Efekt</b> <b>(pozitiv)</b>	<b>Efekt</b> <b>(negativ)</b>
Disa lloje erezash të ndryshme (Për industrinë e sallamit)		0.01
Lupuline (jane mikroganjizma për prodhimin e majasë së birrës)		3.70
Shajak prej materialeve tekstile jo të veshur apo laminuar		0.40
Krisafë alumini me trashësi të ndryshme		1.80
<b>EFEKTI NEGATIV (Në milione LEKE)</b>		<b>5.91</b>

**“PAKETA FISKALE 2004”**

<b>Paketa Fiskale - Efektet e OBT-se per vitet e meparshme (2000,2001,2002,2003) dhe 2004</b> Ne milione leke	<b>Efekti Negativ</b>
<b>Viti 2000</b> Melci, qumesht, vezet e shpendeve, bizele, mashurka, pure, recelna, komposto frutash,pergatitje te perdorura ne industrine epijeve, ushqime per kafshet, kripe, bitum nafte, sulfate alumini, ngjyrues, forma primare te plastikave, lidhjet e librave,paisje qeramike e qelqi per laboratore,ampula farmaceutike,artikuj kuzhine prej qelqi,baker e lidhje bakri, artikuj te tjere prej bakri, artikuj te tjere.	<b>69</b>
<b>Viti 2001</b> Disa lloje sallamrash, cimcakize, cokollata dhe embelsira te tjera	<b>20</b>
<b>Viti 2002</b> Peshku dhe kafshet guackore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jovertebrore ujore,fara vajore,vajra te ndryshem ushqimore. Sardele e konserva, peptone e derivate.	<b>280</b>
<b>Viti 2003</b> Ushqyesit automatike te dokumentave, ushqyesit e letrave, makina perzgjedhese etj	<b>3</b>
<b>Viti 2004</b> Birre, ekstrakte me origjine vegjetale, estere etj, lende ngjyrosese, pigmente, llaqet ngjyrosese, smalte, glazura e bojra glazure te perdorura ne industrine e qeramikes e te qelqit, vajra esenciale, perzierjet e substancave aromatike te perdorura ne industrine e pijeve, substanca albuminoidale, ngjitesa te ndryshem, mbetje , kthime dhe monofilamente prej plastike, preforma plastike, trungje halore e jo halore, qymyr druri, artikuj druri, leter, disa lloje kartonesh, ambalazhe prej letrave e kartoni, etiketa,	<b>580</b>
<b>TOTALI I PERGJITHSHEM I EFEKTEVE NEGATIVE NGA OBT</b>  NE MILIONE LEKE	<b>952</b>

**“PAKETA FISKALE 2004”**

**Totali i Efekteve ne te Ardthurat Doganore**

<b>Tarifa Doganore</b> <i>Ne milione leke</i>	<b>Efekti Pozitiv</b>	<b>Negativ</b>
1. MTL-te		949,20
2. Propozimet e Biznesit		5.91
3. OBT-ja		952.00
<b>Total Efekt Negativ</b>		<b>1,907.11</b>

**Totali i Efekteve te Paketes Fiskale ne Buxhetin e vitit 2004**

<b>Paketa Fiskale - Efektet</b> <i>Ne milione leke</i>	<b>Efekti Pozitiv</b>	<b>Negativ</b>
1 Taksa e Rruges Dures - Kukes		3,300
2 Taksa per regjistrimin e automjeteve	1,450	
3 Akciza e karburantit	1,850	
4 Lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet	700	
5 Ligji i akcizave (i cili hyrine fuqi 1.7.03)	1,000	
7 MTL-te		949.2
8 Propozimet e Biznesit		6
9 OBT-ja		952
<b>Efekti Total</b>	<b>5,000</b>	<b>5,207.2</b> <b>-207</b>